


Bashkia Durrës



Raporti Performancës 2021



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2020 të Bashkisë Durrës.

[Dures - Raporti i Performances 2021 | Tableau Public](#)

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Durrës me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe grupin Teknik të Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021	4
Burimet e Financimit	5
Shpenzimet buxhetore	6
Investimet	7
Administrimi i bashkisë	8
Menaxhimi i mbetjeve	10
Rrjeti rrugor rural	12
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	16
Ndriçim rrugësh	19
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	21
Shërbime publike vendore	23

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshebull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021

Bashkia Durrës

Bashkia Durrës arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë ka pësuar rënie. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë biznet e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Shërbimet edhe pse nën ndikimin e rënies së volumit të xhiros duke u krahasuar me vitin 2020, kur pothuajse u mbyllën totalisht njësitë e bar-restoranteve, e rimorën disi veten në vitin 2021. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Në tërësi bizneset pësuan rënie në prodhim e shërbime. Bashkia karakterizohet nga shërbimi hoteleri-turizëm i lidhur ngushtë me sektorin e turizmit detar, por edhe nga prodhimi bujqësor. Kujtojmë që sektori i turizmit u pati një impak negativ në vitin 2020, duke e rimarrë veten gjatë vitit 2021, gjithësesi nuk është rekuperuar ende të ardhurat që ky sektor solli në vitin 2019 si një nga vitet më të mira të turizmit në gjithë dekadën e fundit. Kjo reflektohet në faktin që të ardhurat nga taksat, tarifatat dhe gjithë burimet e vendore të bashkisë rritur në mënyrë të rëndësishme krahasuar me vitin 2020. Rritjen më të lartë e kanë taksat dhe tarifatat vendore (me mbi 50% rritje).

Buxheti i bashkisë në fund të vitit 2021 rezulton të ketë alokuar rreth 4% më shumë fonde sesa një vit më parë duke reflektuar kështu rritjen e burimeve të financimit.


Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:

- ✧ Përgjysmimi i fondeve për investime kundrejt një viti më parë
- ✧ Mbështetje me shërbime të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe rrjetit rrugor duke zënë një peshë nga më të lartat në buxhetin e bashkisë (17% të buxhetit secila)
- ✧ Rritjen e numrit të personelit të bashkisë
- ✧ Rritja e rëndësishme e të ardhurave të veta në totalin e burimeve të financimit të bashkisë.

Ekzekutimi i buxhetit ka arritur të përdorë të gjitha të burimet e financimit, duke arritur eficiencë në përdorimin e tyre në kohë sipas planifikimit buxhetor.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (Në mijë Lekë)		FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI në %
		3,453,213	2,904,486	3,389,074	3,608,607	94%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Fakt Vs Plan 2021 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat lokale	615,031	439,853	712,692	808,307	88%
	Të ardhura nga taksat e ndara	252,096	274,928	292,622	349,350	84%
	Të ardhura nga tarifa vendore	392,977	312,170	479,598	577,105	83%
	Të ardhurat e tjera	94,137	80,971	90,173	59,856	151%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e pakushtëzuar	817,362	842,615	863,218	863,218	100%
	Transferta e pakushtëzuar sektoriale/specifike	377,968	378,397	427,438	427,438	100%
	Trasferta specifike			52,111	52,111	100%
TRASHËGIMIA NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi nga viti i shkuar	903,642	575,552	471,222	471,222	100%




Bashkia mbështetet në pothuajse gjysmën e buxhetit të saj nga nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë rreth 50% e totalit të të ardhurave. Burimet e financimit u karakterizuan nga:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 17% kundrejt vitit 2020 dhe u realizuan në masën 94% të planit të vitit 2021;
- ✿ Të ardhurat nga burimet e veta të bashkisë u rritën në total me 42% kundrejt një viti më parë si rrjedhojë e mirëmenaxhimit të të ardhurave vendore nga administrata fiskale e bashkisë
- ✿ Pesha e të ardhurave nga burimet e veta është rritur.

Figura 1. Pesha e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Shpenzimet buxhetore



Shenim: Këtu nuk janë përfshirë shpenzimet nga transfertat e kushtëzuar, nga FZHR dhe nga fondet e rindërtimit.


Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rritje kundrejt vitit 2020 me rreth 4%, duke reflektuar kështu rritjen e burimeve të financimit kryesisht nga të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifatat vendore, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 70%, ose një mosrealizim prej 30% i planit të bashkisë si rrjedhojë e investimeve që nuk u realizuan në arsimin parashkollor dhe atë bazë të financuar me fonde të qeverisë qendrore. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ Administrimi i bashkisë
- ✿ Menaxhimi i mbetjeve
- ✿ Rrjeti rrugor rural
- ✿ Arsimi bazë përfshirë parashkollorin
- ✿ Ndriçim rrugësh
- ✿ Mbrojtja nga zjarri
- ✿ Shërbime publike vendore

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (Në mijë Lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	1,053,285	656,949	550,610	1,277,771	43%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve


Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 551 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet kanë rënë me rreth 16%, për rrjedhojë edhe kontributi i tyre në buxhet është zvogëluar. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2021 kundrejt planit është në masën 43%, ose një mos realizim i mbi gjysmën së planit fillestar për shkak të investimeve të financuara nga qeveria qendrore në projekte të arsimit parashkollor dhe atë bazë. Këtë vit i është dhënë prioritet investimeve për rindërtimin të cilat nuk janë paraqitur në këtë tabelë. Gjatë vitit 2021, për procesin e rindërtimit, me fondet e qeverisë qendrore, janë investuar 1.343.183 mijë lekë.

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2021 tregojnë se:

- ✿ Investimet zënë në fund të vitit 2021 rreth 22% të buxhetit të bashkisë një peshë e moderuar në totalin e shpenzimeve të bashkisë, sidomos për një bashki të madhësisë së Durrësit.
- ✿ Fokusi i investimeve janë shërbimet e infrastrukturës rrugore, menaxhimit të mbetjeve, shërbimet publike, ndricimi rrugor, strehimi socia, arsimit bazë dhe parashkollori etj.

Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	413,315	16%	76%



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↓	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në % kundrejt vitit të kaluar)	0	-1	15	0
↓	Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	0.23	0.12	2.09	0.00
→	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	2.15	2.00	1.63	2.00

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Ditë trajnimi në total	112.00	120.00	93.00	120.00
Numri total i personave të trajnuar	52.00	60.00	57.00	60.00

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri total i punonjësve të bashkisë	1,719	1,728	1,772	1,787
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	394	394	437	437
Numri total i punonjësve ne njesite shpenzuese	1,325	1,334	1,335	1,350
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	4	2	37	0
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	1	0	15	0
Shpenzime për investime Në mijë lekë	2,195	1,511		82,807
Shpenzime korente Në mijë lekë	201,407	247,705		433,234

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 76% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 16% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2021 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Janë marrë më shumë masa disiplinore për punonjësit e bashkisë, si rrjedhojë e rritjes së monitorimit të punës së punonjësve e për rrjedhojë kjo ka sjellë rënie në vlerat e treguesit të performancës së punës së tyre
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Janë ofruar trajnime edhe pse në kushte pandemie për personelin e bashkisë.
- ✿ Është rritur numri i personave që kanë lëvizur nga puna si rrjedhojë e masave disiplinore të marra për shkak të cilësisë së punës, duke ulur qëndrueshmërinë e administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Administrimi i bashkisë	2,195	1,511	6,678	77,807	9%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje pajisje kompiuterike			5,827	8,000	73%
Blerje pajisje zyrash			851	900	95%
FV ekran LED perpara Bashkise				2,000	0%
FV kamera sigurie				700	0%
FV sistem konferencash per sallen e keshillit bashkiak				5,500	0%
Kolaudim			0	76	0%
Mbikqyrje			0	631	0%
Rikonstruksion i godines se Bashkise			0	25,000	0%
Rikonstruksion të godinave të Njësive Administrative			0	15,000	0%
Shtimi i funksionaliteteve te kontrollit dhe kalkulimeve te taksave, vjeljes se detyrimeve dhe menaxhimit me eficient te buxhetit fiskal ne sisitemin ekzistues te Bashkise			0	20,000	0%
Blerje pajisje kompjuterike			5,827	8,000	73%

Menaxhimi i mbetjeve

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	437,426	17%	87%




Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i mbetjeve: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i mjedisit duke mirëmenaxhuar mbetjet urbane për të mbrojtur shëndetin e popullatës dhe krijuar kushte më të mira për shëndetin e popullatës.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Buxheti për menaxhimin e mbetjeve kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuar (Mijë Lekë për 1 tonë mbetje)	4,087	8,802		5,223
→	Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet dhe Nj.Administrative (Ndryshimi në herë në javë)	0	0	0	0
↑	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës (në %)	91	91	100	91
↑	Raporti i territorit të mbuluar me shërbim kundrejt totalit të territorit (në %)	36	37	38	39
↑	Raporti shuma totale e arketuar për shërbimin kundrejt shumës së faturuar nga klientët (në %)	50	22	63	50
○	Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (në %)	46	29		61

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA herë në javë)	5	5	5	5
Frekuenca në Qytet	7	7	7	7
Frekuenca në Njësitë administrative	3	3	3	3
Popullsia e mbuluar me shërbim	297,140	300,850	334,448	300,850
Popullsia e mbuluar me shërbim në Njësitë administrative	71,606	72,920	68,615	72,920
Popullsia e mbuluar me shërbim në Qytet	225,534	227,930	265,833	227,930

Sasia e mbetjeve të grumbulluara dhe transferuara (Në tonë)			55,673	
Sasia e mbetjeve në Njësitë administrative			22,153	
Sasia e mbetjeve në Qytet			33,520	
Sipërfaqe e mbuluar me shërbim	274	274	338.3	338.3
Sipërfaqe e pastruar në vit (km2)	250	250	323	323

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe totale e bashkisë	338.3	338.3	338.3	338.3
Të ardhura nga tarifa e pastrimit	170,003	112,713	205,414	256,334
Nga bizneset	128,790	95,914	137,448	147,144
Nga familjet	41,213	16,799	67,966	109,190
Popullsia totale nën administrimin e Bashkisë	327,828	332,102	334,448	332,102
Popullsia në Njësitë administrative	102,294	104,172	104,976	104,172
Popullsia në Qytet	225,534	227,930	229,472	227,930
Shuma totale e faturuar për shërbimin e menxhimit të mbetjeve	339,724	383,294	437,426	503,172

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për grumbullimin, transferimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në qytet dhe njësitë administrative si edhe pastrimin e rrugëve në pjesën urbane të bashkisë në masën 87% të planit buxhetor për vitin 2021. Bashkia shpenzon rreth 17% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Është ruajtur frekuenca e tërheqjes së mbetjeve nga kazanat e grumbullimit që ka vendosur bashkia, 1 herë në ditë në zonën urbane dhe 2 herë në javë në zonën rurale;
- ✿ Bashkia përgjatë këtij viti ka bërë përmirësuar në mënyrë të rrënjësishme shërbimin duke arritur një mbulim me shërbim në masën 100% të popullatës qoftë në qytet ashtu edhe në pjesën rurale të saj
- ✿ Bashkia ka rritur grumbullimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit të pastrimit të qytetit duke arritur një normë arkëtimit e cila bën që të rritet edhe mbulimi i kostove nga të ardhurat e tarifës nga 22% që ishte në vitin 2020 në masën 63% në vitin 2021. Gjithësesi mbulimi i kostove mbetet ende larg nivelit të synuar i cili duhet të jetë 100%.
- ✿ Bashkia përgjatë vitit 2021 ka punuar për mbylljen e vend depozitimit të fushës së mbetjeve e cila ishte kthyer në një hotspot mjedisor i cili rrezikonte shëndetin e popullatës. Mbetjet janë dërguar në landfillin e Sharrës i cili është kthyer tashmë në një vend depozitimi rajonal për qarkun e Tiranës dhe Durrësit, ku sot jo vetëm bashkia jonë depoziton aty por edhe bashki të tjera të qarkut si Kamëz, Vorë, Kavajë etj. Transporti i mbetjeve në Sharrë është financuar nga Qeveria qendrore kjo ka bërë që edhe buxheti dhe pesha për këtë shërbim të rriten në mënyrë të rëndësishme në tërësinë e buxhetit të bashkisë.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Menaxhimi i mbetjeve	8,460	14,975	12,822	40,822	31%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje autoagregate mbetjesh urbane (3 cop)			0	25,000	0%
Blerje kazane per mbetjet urbane			12,822	12,822	100%
FV kosha mbeturinash te vegjel			0	3,000	0%

Rrjeti rrugor rural

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	423,168	17%	61%




Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Raporti i rrugëve të asfaltuara ndaj totalit të rrugëve (te asfaltuara, cakull etj) në %	88	91		91
↑	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	3	-3
→	Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
↑	Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	3	-3
○	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	25	36		
	Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	24	31		
	Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	1	5		
→	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor (në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane)	2,481	916		2,632

Performanca e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 61% të planit 2021 në një vlerë prej mbi 336 milionë Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 80% të tyre. Bashkia shpenzon rreth 17% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✿ Është zgjeruar rrjeti rrugor në pjesën urbane të tij me rreth 3 kilometra linear
- ✿ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- ✿ Janë përdorur paratë në mënyrë të kujdesshme për të rritur eficiencën e përdorimit të tyre, duke rritur rrjetin rrugor, duke mirëmbajtur atë pa ulur cilësinë e punimeve.

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	162.0	198.0	323.0	198.0
Rrugë rurale të mirëmbajtura	42.0	73.0	206.0	73.0
Rrugë urbane të mirëmbajtura	120.0	125.0	117.0	125.0
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	183.0	191.0	85.0	191.0
Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara	47.0	55.0	3.0	55.0
Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara	136.0	136.0	55.0	136.0

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	209	209	212	209
Rrjeti rrugor rural	73	73	73	73
Rrjeti rrugor urban	136	136	139	136
Numri aksidenteve rrugore (këmbësorë + automjete)	0	0	78	0
Numri i aksidenteve të automjeteve	0	0	96	0
Numri i aksidenteve të këmbësorëve	0	0	0	0
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë Lekë	518,471	191,482	423,186	520,767

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Rrjeti rrugor rural	416,235	106,033	335,861	597,179	56%
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Azhornim topografik i fshatit Rrushkull			0	4,000	0%
Blerje asfalt per rruge urbane dhe rurale			67	67	100%
Blerje asfalti			39,263	42,000	93%
Blerje beton per riparime rruge, sheshe e trotuare			8,761	10,000	88%
Blerje beton per riparime rrugesh			342	342	100%
Blerje kamion me vinç 5 ton			3,924	4,000	98%
Blerje materiale inerte per riparime rruge,sheshe, trotuare			9,988	10,000	100%
Hartim oponenca teknike			0	2,000	0%
Kolaudim			231	1,057	22%
Mbikqyrje			5,197	12,305	42%
Mbikqyrje e objektit ; "Reabilitimi i ndricimit rruga "Agaveve", L.13"			72	72	100%
mbikqyrje Rikonstrukcion rrruga Kont Urani			0	105	0%
Ndertim rrjeti shperndares ujesjellesi Rrushkull (detyrim i prapambetur i trasheguar nga ish komunat)			4,283	4,283	100%
Ndertim ure ne fshatin Romanat			884	2,000	44%
Pilotim I rruges "Luftetatret e Lirise"			0	5,821	0%
Pjese kembimi per automjetet e ND. Rruga			4,122	4,771	86%
Projekt zbatimi per ndertimin e shetitores se plazhit Durres nga Ura e Dajlanit deri ne godinen e Kavalishences			0	5,000	0%
Rikonstrukcion rruga "Ali Pashe Tepelena, At Gjergj Fishta dhe Migjeni"			0	15,000	0%

Rikonstruksion rruga "Azem Hajdari-Migjeni" NJA RRASHBULL			6,000	14,000	43%
Rikonstruksion rruga "Pelikani" Plazh			0	5,800	0%
Rikonstruksion rruga "Zeqai Spahiu"			0	2,910	0%
Rikonstruksion rruga Danubi		0	10,314	28,000	37%
Rikonstruksion rruga Demëve Rrushkull			14,123	27,400	52%
Rikonstruksion rruga Dervish Hima			0	15,000	0%
Rikonstruksion Rruga e Ohrit (Loti II)		0	20,000	20,000	100%
Rikonstruksion rruga Kashta e kumtrit (loti II)		0	14,955	20,000	75%
Rikonstruksion rruga Kastrioti		0	7,984	8,000	100%
Rikonstruksion rruga Liqenit të Radës, Manëz			0	15,000	0%
Rikonstruksion rruga Papa Klementi II			1,514	18,400	8%
Rikonstruksion rruga paralel me hekurudhen-Plazh (Apulia)		0	0	20,000	0%
Rikonstruksion rruga Shekspiri			2,930	5,000	59%
Rikonstruksion rruga Shen Pjeter		0	30,000	30,000	100%
Rikonstruksion rruga Shkumbini		0	30,000	30,000	100%
Rikonstruksion rruga Syri i detit			5,359	8,000	67%
Rikonstruksion rruga Tepelena		0	35,000	35,000	100%
Rikonstruksion rruga Vau Sals (Katund i Ri)			3,305	5,000	66%
Rikonstruksion rruge nja Ishem			0	20,000	0%
Rikonstruksion rruge nja katund I ri			12,860	20,000	64%
Rikonstruksion rruge nja Manze			18,554	30,000	62%
Rikonstruksion rruge nja Rashbull			2,161	2,162	100%
Rikonstruksion rruge nja Sukth			18,586	30,000	62%
Rikonstruksion rruge te brendshme ne plazh - Qafbot			0	5,000	0%
Rikonstruksion segmenti rrugor "Ksanthipi Syko" dhe "Abdyl Ypi"			0	2,915	0%
Rikonstruksion rruga "Integrimi"			4,269	10,000	43%
Rindertim i kalimeve per ujrat e larta Nja Nr. 4 Durres			0	8,000	0%
Sinjalistike rrugore			19,706	20,000	99%
Sistemim asfaltim rruge Lagja Erzen (detyrim i prapambetur i trashëguar nga ish komunat)			0	405	0%

Sistemim asfaltim rruge Lagja Stalla (detyrim i prapambetur i trashëguar nga ish komunat)			993	993	100%
Studim projektim per parkim ne qytet			0	5,000	0%
Studim projektim per rikonstruksionim e rruges"Adria" nga rrotonda e Ures se Dajlanit deri tek Rotonda prane Stacionit te Trenit			0	3,600	0%
Studim projektim Unaza spital Currila			0	3,000	0%
Studim projektim Unaza Spitalle-Currila			0	5,000	0%
supervizim			0	204	0%
supervizim objekti : Rikonstruksion rr. Lapidari Qerret (detyrim i prapambetur i trashëguar nga ish komunat)			110	110	100%

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	357,553	14%	63%




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korentë dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	23	23		23
➔	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	14	15	15	13



Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	25	24	24	23
Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)	4,173	4,696	5,325	4,215

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	138	138	138	138
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	804	795	795	804
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	105	105	106	106

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	3,625	3,650	3,614	3,650
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	15,552	15,560		15,560
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç			956	
Mësues në sistemin parashkollor	209	209	242	209
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	1,399	1,399	1,234	1,399
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	19,700	18,960	18,793	18,660
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë Në mijë lekë	438,201	493,070	357,553	567,479

Performanca e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 63% të planit 2021. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 14% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është ruajtur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë në masën 100% të fëmijëve që kanë moshën e duhur për të ndjekur sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Është ruajtur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues;
- ✿ Është rritur financimi i institucioneve arsimore duke synuar përmirësimin e kushteve të mësimit si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit
- ✿ Investimet e planifikuara për përmirësimin e ndërtesave dhe kushteve të tyre janë nga më të rëndësishmet në buxhetin e bashkisë. Përgjatë këtij vitit janë përmirësuar shkollat 9 vjeçare në: Hamallaj, Kucok, Ndra, Ishëm, Fshat Rinia, Besnik Hidri – Shën Vlash, etj si edhe kopshtet si: Gjuricaj – Ishëm, Neim Babameto, Isuf Ferra,

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Arsimi bazë përfshirë parashkollorin	154,219	224,365	40,811	185,594	22%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje pajisje elektroshtëpiake			239	240	100%
Blerje pajisje për shkolla kopshte			19,326	25,000	77%
Furnizim vendosje sistem kamera sigurie ne institucionet e arsimit parauniversitar			0	10,000	0%
Hartim projekti per godina arsimore ne njesite administrative			0	5,000	0%
Kolaudim			407	570	71%
Mbikqyrje			229	2,702	8%
Ndertim kopshti i ri ne Gjuricaj NJA ISHEM			0	16,000	0%
Ndërtim shkolla 9 vjeçare në Fshat Rinia			4,457	4,457	100%
Ndërtim shkolla 9 vjeçare" Hamallaj "			11,751	11,751	100%
Rikonstruksion kopshti 1 Maji			2,333	2,582	90%
Rikonstruksion kopshti "Neim Babameto"			2,070	3,217	64%
Rikonstruksion kopshti Isuf Ferra			0	20,000	0%
Rikonstruksion shkolla 9 vjecare Zyber Sallaku , Kucok			0	30,000	0%
Rikonstruksione te ambienteve te institucioneve arsimore			0	15,000	0%
Rikonstruksione të ambienteve të institucioneve arsimore			0	12,000	0%
Rikonstruksion palestra e shkolles Besnik Hidri, Shenvlash			0	20,000	0%
Rikualifikim i këndit të lojrave dhe krijim hapësirë rekreative tek kopshti "Neim Babameto" (2.374.534 leke kontribut i ËORLD VISION)			0	3,075	0%
Rrethimi dhe sistemime te ambienteve te shkolles 9 vjecare Ndrac, NJA Ishem			0	4,000	0%

Ndriçim rrugësh

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	128,518	5%	76%



Qëllimi i programit buxhetor

Ndricimi i hapësirave publike për të rritur sigurinë në qarkullimin rrugor dhe sigurinë publike në përgjithësi.

Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Ndricimi i rrugëve: korrente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Raporti sipërfaqe e mbuluar me ndriçim kundrejt totalit të sipërfaqes publike të bashkisë (në %)	42	45	45	45
○	Shpenzime operative dhe mirëmbajtje plus investime për ndricimin e hapësirave publike kundrejt sipërfaqes totale të ndriçuar (Mijë Lekë të shpenzuara për 1 kilometer katror hapësirë publike të ndriçuar)	862	522	878	1,020
○	Të ardhura nga tarifat për ndricimin e hapësirave publike kundrejt totalit të shpenzimeve të bashkisë për mbulimin me ndriçim të hapësirave publike (raporti në %)	31	33	36	42

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndricimin e hapësirave publike duke paguar faturat e energjisë elektrike si edhe mirëmbajtjen dhe investime në sistemin ndricues të hapësirave publike në masën 76% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 5% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në ndricimi ne hapësirave publike kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✳️ Janë shtuar hapësirat publike të ndricuara, ku është shtuar edhe sistemi LED që ofron një eficiencë të energjisë elektrike

- ✳️ Jemi përpjekur të rrisim eficiencën e përdorimit të parasë publike për të ulur koston e ndricimit të një metri katror hapësirë publike. Kjo vihet re sesi është pothuajse përgjysmuar kosto në dy vite më parë. Për shkak të rritjes së investimeve gjatë vitit të fundit ende nuk kemi një përlllogaritje të saktë të koston për njësi ndricim.
- ✳️ Është për tu përmendur ndricim i ri tërësisht në lagjen Abaz Celkupa që u përfundua me sukses gjatë vitit 2021 si edhe projektet e ndricimit në rrugët: Hysen Mushketa, Vëllazërimi dhe Kristo Sotiri të cilat do të përfundojnë gjatë vitit 2022.

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe e hapësirave publike e mbuluar me ndriçim Në km2	143.60	153.86	157.00	153.86

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzime për ndriçimin e hapësirave publike Në mijë lekë	123,781	80,284	128,518	168,448
Sipërfaqe publike e bashkisë (total sipërfaqe) Në km2	338	338	3,383	338
Të ardhura nga tarifat për ndriçimin e hapësirave publike Në mijë lekë	38,553	26,174	47,109	65,892

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Ndriçim rrugësh			14,419	53,342	27%
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje miniautokullë			2,385	2,500	95%
Kolaudim		0	30	93	32%
Kolaudimi			0	23	0%
Mbikqyrje		0	218	1,001	22%
Ndricim rruga Abaz Celkupa			11,786	12,050	98%
Ndricim Rruga Hysen Myshketa 1752 m			0	17,190	0%
Ndricim rruga Vllazerimi			0	11,686	0%
Ndricim i rruges "Kristo Sotiri" NJA 4 DURRES			0	8,800	0%

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

	Vlera në m ijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	99,983	4%	56%




Figura 9: Kategoritë e shpenzimeve për programin Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia garanton shërbimin zjarrfikës, parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Dalja nga stacioni (ndryshimi në sekonda)	-7	-5	0	0
Kosto mesatare e një rasti të menaxhuar nga Stacioni MZSH (Mijë lekë për një rast)	131	98	246	282
Mbulimi kostove të shërbimit MZSH nga të ardhurat e shërbimit (në %)	0	0	0	2
Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në numër)	-384	-21	2,157	
Numri i stacioneve funksionale të MZSH në bashki	2	2	2	2

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Koha e daljes nga stacioni në sekonda (mesatare ditën plus natën)	53.0	48.0	48.0	48.0
Numri i stacioneve funksionale të MZSH që ka bashkia	2	2	2	2
Raste të menaxhuara nga MZSH	610.0	610.0	733.0	610.0

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzime për investime Në mijë lekë	6,077	6,600	0	39,214
Numri punonjeshve MZSH	48	48	46	48
Të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me fikse zjarri, etj) Në mijë lekë	0	0	5,125	3,000
Total shpenzime për MZSH Në mijë lekë	79,974	59,990	99,983	180,056

Performanca e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për mbrojtjen nga zjarri në shumën 100 milionë lekë për vitin 2021, në masën 56% të planit vjetor. Bashkia shpenzon rreth 4% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Gjatë vitit 2021 performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është konsoliduar njësi e zjarrfikëses e cila iu transferua bashkisë si funksion në vitin 2016, duke shtuar edhe një qendër të re. Tashmë bashkia ka 2 qendra për menaxhimin e zjarreve dhe mbrojtjen civile;
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të punonjësve zjarrfikës;
- ✿ Janë rritur rastet e parandalimit të zjarreve në mënyrë të rëndësishme, duke justifikuar kështu edhe investimet në zgjerimin e fushës së shërbimit;
- ✿ Është ulur koha e reagimit ndaj njoftimeve për raste zjarri apo mbrojtje civile;
- ✿ Gjithashtu gjatë këtij viti pandemik struktura e shpëtimit i ka ardhur në ndihmë popullatës;
- ✿ Kjo njësi e bashkisë i ka ardhur në ndihmë edhe zonës së Rrashbullit në Ishëm për mbrojtjen e popullatës nga rrëshqitjet e tokës për ndërhyrjet e të cilave janë harxhuar rreth 7 milionë lekë.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	6,077	6,600	6,702	39,214	17%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje pompa thithese per MZSH (4 cop)			0	500	0%
Fond per perforcimin e terrenit nga rreshqitja ne zonat e njesive administrative Nr.2, Nr.4 Rrashbull Ishem			6,702	9,503	71%
Kolaudim			0	19	0%
Mbikqyrje			0	157	0%
Perforcimi i terrenit nga rreshqitja e dherave ne faqen e kodres ne fshatin Shkallnur ne njesine administrative Rrashbull			0	7,999	0%
Perforcimi i terrenit nga rreshqitja e dherave ne lagjen nr.10 ne koder prane Currilave nga ana veriore e perendimore e saj			0	12,936	0%
Rindertim i kalimeve(tombino) të prishura nga përmbytjet, në NJA Katund I Ri			0	8,100	0%

Shërbime publike vendore

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	93,394	4%	48%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative.

Figura 10: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)	0.0	0.0		0.0
○	Rrënjë pemë dekorative fondi i pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në numër)	400	500		500
○	Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave (Ndryshimi vjetor në %)				
○	Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %)	8.5	8.0		8.3
➔	Trotuare (Ndryshimi vjetor në km linear)	9.0	0.0	0.0	0.0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrënjë pemë të mbjella në vit	400.0	500.0		500.0
Sipërfaqe e gjelbëruar në vit në Km katrorë				

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe totale e gjelbër publike në Km2			5	
Sipërfaqe totale e bashkisë në Km2	338	338	3,383	338
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	32,400	32,900	519,410	33,400
Trotuare në km linear	92	92	92	92
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit Në mijë lekë	33,253	25,070	38,864	48,030
Të ardhurat nga tarifat vendore Në mijë lekë	392,977	312,170		577,105
Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave publike Në mijë lekë			24,588	30,992

Performanca e shërbimit

Bashkia ka shpenzuar fonde për shërbimet publike të cilat përfshijnë gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike në masën 48% të planit 2021. Bashkia alokon rreth 4% të buxhetit të saj për këto shërbime, duke shpenzuar në total rreth 93 milionë lekë për këtë funksion. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është rritur fondi i pemëve dhe bimëve dekoruese të ambjenteve publike të gjelbëruara nga bashkia;
- ✿ Janë rritur sipërfaqet e gjelbëruara të bashkisë, nëpërmjet zgjerimit të hapësirave rikrijuese dhe ruajtjes dhe mirëmbajtjes së atyre ekzistuese nën administrimin e bashkisë;
- ✿ Janë rritur fondet për mirëmbajtjen e varrezave publike në cdo njësi administrative të saj duke shtuar edhe sipërfaqe të reja. Për këtë janë shpenzuar rreth 20 milionë lekë deri në fund të vitit 2021;
- ✿ Bashkia zotohet se do të përmirësojë raportimin për këto shërbime në raportet e ardhshme të saj.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Shërbime publike vendore	97,883	9,957	14,872	67,612	22%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Gjelberim ne qytet			0	20,000	0%
Kolaudim			0	99	0%
Mbikqyrje			100	888	11%
mbikqyrje Rikualifikim kuartalla I.18			0	135	0%
Ndertim kende lojrash per femije ne qytet			0	7,000	0%
Rikonstruksion varreza			14,771	20,000	74%
Rikualifikim i hapesirave te gjelberta ne qytet			0	19,491	0%